



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 2 gusht 2021
Nr. ref.:RK 1820/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI192/20

Parashtrues

Muhamed Aliu

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 87/2020, të 6 prillit 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Muhamed Aliu, nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [Rev. nr. 87/2020] e 6 prillit 2020 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).
3. Parashtruesi i kërkesës Aktvendimin e Gjykatës Supreme e kishte pranuar më 17 dhjetor 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes së cilit pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 20 [Vendimet], 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 29 dhjetor 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 30 dhjetor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani, anëtarë.
8. Më 18 janar 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të sjellë në Gjykatë Aktvendimin e Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit.
9. Në të njëjtën datë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
10. Më 29 janar 2021, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi në Gjykatë dokumentet e kërkuara.
11. Më 22 prill 2021, Gjykata i dërgoi një shkresë Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) dhe kërkoi që të sjellë fletëkthesën

që dëshmon se kur parashtuesi i kërkesës e ka pranuar Aktvendimin [Rev.nr.87/2020] të 6 prillit 2020 të Gjykatës Supreme.

12. Më 27 prill 2021, Gjykata Themelore e dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar.
13. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe Rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
14. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
15. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit KSH192/20, emëroi Gjyqtarin Safet Hoxha si anëtarë të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu.
16. Më 31 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, me Vendimin nr. KK160/21 për zëvendësimin e gjyqtareve kryesues në kolegje shqyrtuese, caktoi Kryetaren e zgjedhur të Gjykatës Gresa-Caka Nimani, kryesuese të kolegjit për rastin KI192/20.
17. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani morri detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
18. Më 22 korrik 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

19. Bazuar në shkresat e lëndës, parashtuesi i kërkesës kishte lidhur marrëdhënie pune me Ndërmarrjen Shoqërore “Stacioni i Autobusëve” në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: NSHSA) prej 31 dhjetorit 2011, në pozitën e inkasantit në portë në shërbimin e stacionit të autobusëve.
20. Më 7 qershor 2013, NSHSA përmes Vendimit [Nr.02/187] ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës parashtuesit të kërkesë, me arsyetimin se parashtuesi i kërkesës ishte i suspenduar përkohësisht nga puna në periudhën prej 14

nëntorit 2012 deri më 31 maj 2013, dhe se edhe pas kësaj date ai nuk ishte lajmëruar në punë.

21. Më 1 korrik 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) përmes së cilës kërkoj që të anulohet Vendimi i të paditurës NSHSA [Nr.02/187] i 7 qershorit 2013, për shkak të shkeljes së marrëdhënies së punës në mënyrë të kundërligjshme dhe të obligohet i padituri që paditësin ta kthejë në punë me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.
22. Më 20 tetor 2016, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [C.nr.1545/13] konsideroi të tërhequr padinë e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se edhe pas ftesës në mënyrë të rregullt nga ana e gjykatës, ai nuk është përgjigjur dhe nuk e ka arsyetuar mungesën e tij.
23. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore pranë Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë si të bazuar ankesën e tij, ndërsa aktvendimin e atakuar ta prishë dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.
24. Më 12 dhjetor 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.3125/18] hodhi poshtë si të pasafatshme ankesën e parashtruesit të kërkesës.
25. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion pranë Gjykatës Supreme kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që revizioni të pranohet si i bazuar, të anulohen aktvendimet e të dy gjykatave dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.
26. Më 6 prill 2020, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev.nr.87/2020] refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [Rev.nr.87/2020] e 6 prillit 2020 të Gjykatës Supreme, me pretendimin se është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si dhe me nenet 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
28. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të neneve të lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës, përveç përmendjes së këtyre neneve, në asnjë mënyrë nuk ka argumentuar se si dhe pse atij i janë shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ.

29. Parashtruesi i kërkesës ndër të tjera kërkon, siç thekson ai *“dhënien e mundësisë së deklaramit në Gjykatën Themelore, për çështjen time e cila është jetike për mua dhe familjen time pasi që tani kam mbetur i pa punë dhe askush nuk më merr në punë”*.
30. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që rasti t'i kthehet Gjykatës Supreme në rivendosje. Po ashtu thekson se rasti i tij është i njëjtë me rastin e Gjykatës KI71/18.

Dispozitat Relevante Ligjore

LIGJI Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

Ndërrimi i adresës Neni 116

116.1 Në qoftë se pala ose përfaqësuesi i saj, gjatë zhvillimit të procedurës apo para se të kalojë afati prej gjashtë muajsh pas përfundimit të procedurës me vendim të formës së prerë, e ndërrojnë adresën në të cilën bëhet dorëzimi i shkresave kanë për detyrë që për këtë gjë ta njoftojnë menjëherë gjykatën.

116.5 Në qoftë se pala apo përfaqësuesi i saj nuk e njoftojnë menjëherë gjykatën për ndryshimin e adresës, gjykata do të urdhërojë që dërgimet e mëtutjeshme të shkresave të bëhen me anë të afishimit të tyre në tabelën e shpalljeve në gjykatë. Kjo mënyrë e komunikimit bëhet deri sa pala apo përfaqësuesi i saj ta njoftojë gjykatën për adresën e re të saj.

116.6 Komunikimi nga paragrafi 5 i këtij neni konsiderohet i kryer pas kalimit të shtatë ditëve nga dita e afishimit të shkresës në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

SEANCA PËRGATITORE a) Dispozita të përgjithshme

Neni 409

409.1 Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet.

409.2 Po që se në seancën përgatitore nuk vjen i padituri që është thirrur rregullisht shqyrtimi vazhdon të bëhet me palën paditëse të pranishme.

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregulloren e punës.

32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

1. “Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

[...]

7. “Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

33. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

34. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [Rev.nr.87/2020] të 6 prillit 2020 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
35. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e

pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi (2) i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

36. Gjykata në këtë aspekt dhe fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës kishte kontestuar në gjykatat e rregullta Vendimin e NSHSA [Nr.02/187] për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, duke pretenduar kundërligjshmërinë e tij, sepse në esencë, sipas tij përkundër vullnetit që të kthehet në punë ai ishte i penguar nga gjykata.
37. Çështja e parashtruesit të kërkesës ishte shqyrtuar përmes 3 (tre) vendimeve gjyqësore, duke u vendosur fillimisht nga Gjykata Themelore e sipas së cilës, padia e parashtruesit të kërkesës ishte konsideruar e tërhequr për shkak se parashtruesi i kërkesës nuk i ishte përgjigjur ftesës së gjykatës dhe mungesën nuk e kishte arsyetuar. Gjykata e Apelit kishte hedhë poshtë si të pasafatshme ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa Gjykata Supreme kishte refuzuar si të pa bazuar revizionin. Parashtruesi i kërkesës kërkon *“ dhënien e mundësisë së deklarimit në Gjykatën Themelore, për çështjen time e cila është jetike për mua dhe familjen time pasi që tani kam mbetur i pa punë dhe askush nuk më merr në punë”*.
38. Lidhur me këtë pretendim, dhe siç është reflektuar tek pjesa që ndërlidhet me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, përtej pretendimit se vendimet e gjykatave të rregullta janë në kundërshtim me nenet 31, 32, 53 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur para Gjykatës asnjë argument dhe/ose arsyetim konkret përkitazi me shkeljet e të drejtave të tij e të cilat ai i pretendon.
39. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton praktikën e saj gjyqësore sipas së cilës vetëm përmendja e një neni të Kushtetutës, pa arsyetim të qartë dhe adekuat se si është shkelur ajo e drejtë, nuk mjafton si argument për të aktivizuar makinerinë e mbrojtjes që ofron Kushtetuta dhe Gjykata, si institucion që përkujdeset për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (shih, në këtë kontest, rastet e Gjykatës KIO2/18, parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019, paragrafin 36; dhe KI95/19, parashtrues *Ruzhdi Bejta*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 tetorit 2019, paragrafët 30-31; KI26/20, parashtrues *Fatmir Kahrmani*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 tetorit 2020, paragrafi 34).
40. Një qëndrim i tillë i Gjykatës, është i bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Bazuar në këtë praktikë, dhe atë tashmë të konsoliduar të Gjykatës, pretendimet apo ankesat e paarsyetuara

dhe të pambështetura me argumente e prova, shpallen të papranueshme si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese (shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 4. Ankesat e paarsyetuara: mungesa e provave, paragrafët 280 deri më 283).

41. Gjykata gjithashtu rikujton se, Gjykata Supreme kishte arsyetuar në mënyrë të detajuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me afatshmërinë e ankesës së tij. Në këtë aspekt, Gjykata Supreme, përmes Aktvendimit të saj, ndër të tjera, arsyetoi si në vijim:

“Në rastin konkret gjykata nuk ka pas mundësi që komunikimin e shkresave ta bëj personalisht me paditësin, për shkak se paditësi nuk e ka lajmëruar gjykatën për ndërrimin e adresës. Dispozita e nenit 116.par 1 të LPK-së, përcakton detyrimin e palës dhe përfaqësuesit të tyre që ta lajmërojnë gjykatën për ndërrimin e adresës. Moslajmrimi i adresës shkakton pasoja juridike në kuptim të nenit 116. Par.5 të LPK-së, sepse kjo dispozitë, parasheh që komunikimi i shkresave të bëhet nëpërmjet afishimit të tyre në tabelën e shpalljeve në gjykatë. Në këtë rast vlen supozimi ligjor, se komunikimi është kryer në menyrë të rregullt pas kalimit të afatit të përcaktuar ligjor, pas afishimit të shkresave në tabelën e shpalljeve në gjykatë (neni 116 par.6 i LPK-së). Në këtë rast nuk luan rol nëse shkresa duhet të dorëzohet personalisht ose jo personalisht ashtu si është përcaktuar me nenin 110 të LPK-së.

Prandaj, përfundimi i gjykatës së shkallës së dytë ligjërisht është i drejtë dhe si i tillë duhet të mbetet në fuqi për arsye se, ankesën kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësi nuk e ka parashtruar në afatin e përcaktuar ligjor sipas nenit 176 par 1 të LPK, ashtu si drejtë ka vlerësuar gjykata e shkallës së dytë, kjo për faktin se, vendimi mbi tërheqjen e padisë është afishuar në tabelën e shpalljes së gjykatës me datë 20.10.2016, aktvendimi është tërhequr me datë 31.10.2016, pasi që ka qëndruar në afatin e paraparë ligjor. Ankesa e paditësit e parashtruar me datë 19.03.2018, është e pasafatshme pas kalimit të afatit më shumë se një vit, nga dita e dorëzimit të vendimit në menyrë të rregullt, përmes të tabelës së shpalljes së gjykatës.

Pretendimet e ngritura në revizion se paditësi me aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë është njoftuar me vonesë pas lirimit të tij nga paraburgimi dhe shpalljes së tij si i pafajshëm në procedurë penale, u cilësuan si të pa bazuara për arsye se paditësi ka dështuar që pretendimet e veta ti mbështet me fakte në procedurën e ankimimit dhe në revizion, ndërsa nga fletëkthesa që gjendet në lëndë rezulton se vendimi mbi tërheqjen e padisë është afishuar në tabelën e shpalljes të gjykatës për shkak të adresës së panjohur të paditësit. Në këtë kuptim kjo Gjykatë, i refuzoi si të pa bazuara pretendimet e paditësit se ankesa e tij nuk është trajtuar drejtë në këtë procedurë, ndaj dhe është shkelur e drejta në gjykim të drejtë e cila garantohet me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Konventen Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore.”

42. Gjykata në këtë kontekst thekson se Gjykata e Apelit dhe specifikisht Gjykata Supreme kishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës ishte vonuar në paraqitjen e ankesës, dhe me këtë rast kishte lëshuar afatet ligjore të parapara me dispozitat ligjore për paraqitjen e ankesës.
43. Rrjedhimisht Gjykata vëren se, Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme kishin vlerësuar se vendimi për tërheqjen e padisë i marrë nga ana e Gjykatës Themelore është i drejtë, për shkak se parashtruesi nuk kishte lajmëruar gjykatën për ndërrimin e adresës, dhe se moslajmërimi i adresës së re shkakton pasoja juridike, dhe se për këtë arsye edhe komunikimi i shkresave ishte bërë nëpërmjet afishimit të tyre në tabelën e shpalljeve në gjykatë, ku nga ajo datë kishte filluar të llogaritet edhe afati.
44. Gjykata gjithashtu rikujton që, parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e gjykatave të rregullta janë të kundërligjshme dhe në kundërshtim me Kushtetutën, duke u referuar gjithashtu në rastin e Gjykatës KI71/18.
45. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se përveç faktit që parashtruesi i kërkesës ka cekur dhe ka cituar rastin e Gjykatës KI71/18, ai nuk ka elaboruar lidhshmërinë e tij, faktike dhe juridike, me rrethanat e rastit konkret. Gjykata thekson që arsyetimet e vendimeve të tjera gjyqësore duhet të interpretohen në kontekstin dhe në dritën e rrethanave faktike në të cilat janë nxjerrë (shih, ndër të tjera dhe në këtë kontekst, Aktgjykimin në rastin KI48/18 të 4 shkurtit 2019, me parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës* (LDK), paragrafi 275; rastin KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2019, paragrafi 80; dhe KI115/19, parashtrues *Sadete Jusufi*, Aktvendim për papranueshmëri i 21 prillit 2020, paragrafi 51).
46. Siç u sqarua më lart, parashtruesi i kërkesës para Gjykatës nuk sjell asnjë argument apo arsyetim shtesë në mbështetje të pretendimeve të tij për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese. Për pasojë, Gjykata, bazuar në Rregulloren e saj të punës, përkatësisht paragrafin 2 të rregullit 39 të saj, duhet të shpallë këtë kërkesë të papranueshme si qartazi të pabazuar në baza kushtetuese, sepse parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.
47. Gjykata në fund thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe, ndër të tjera, KI56/17, parashtruese *Lumturije Murtezaj* Aktvendim për papranueshmëri i 18 tetorit 2017, paragrafi 42).
48. Prandaj në këto rrethana, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata, duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.

49. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe duhet të shpallet e papranueshme bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe në rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, neneve 20 dhe 47 të Ligjit dhe të rregullit 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 22 korrik 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani